



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË

20829

UDHËZIM

21.11.18

Nr. 38, datë 21.11 2018

PËR KUSHTET DHE PROCEDURAT PËR TRANSFERIMIN HORIZONTAL DHE VERTIKAL BRENDA SISTEMIT TË AFP-SË

Në mbështetje të neneve 16 e 20 pika 4 të ligjit nr. 15/2017, datë 16.02.2017 "Për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë",

UDHËZOJ:

Neni 1

Fusha e zbatimit

1. Ky udhëzim përcakton kushtet dhe procedurat e transferimit në Arsimin Profesional (AP), nga një nivel i kualifikimeve profesionale në një nivel më të lartë (transferimi vertikal), si dhe nga një drejtim/profil i kualifikimeve profesionale në një drejtim/profil tjetër (transferimi horizontal).

Neni 2

Transferimi vertikal brenda sistemit tëAFP-së

1. Në Arsimin Profesional, nxënësi që ka përfunduar me sukses një kualifikim profesional në një nivel të caktuar mund të vijojë kualifikimin profesional në nivelin më të lartë pasues.
2. Nxënësi që përfundon me sukses një kualifikim profesional të nivelit të 4 të KSHK mund të vijojë kualifikimet e mëtejshme në nivelin 5 të KSHK (pas të mesmes) dhe në nivelin 6 të KSHK (Bachelor).
3. Nxënësi konsiderohet që e ka përfunduar me sukses një nivel të caktuar të kualifikimit profesional nëse fiton certifikatën/diplomën përkatëse.
4. Në ofruesit publikë të AP, në raste të veçanta, kur kërkesat për kualifikime profesionale janë më të larta se sa oferta për kualifikime profesionale, ministria përgjegjëse për AFP përcakton kritere të veçanta pranimit për kalimin e nxënësve nga një nivel kualifikimi në një nivel më të lartë.
5. Për t'u regjistruar në një nivel më të lartë të kualifikimit profesional, nxënësi duhet të ketë fituar certifikatën/diplomën e kualifikimit profesional të nivelit paraardhës, si dhe të plotësojë kriteret e veçanta të pranimit (nëse ka të tilla).

6. Transferimi vertikal në Arsimin Profesional duhet të fillojë në përfundim të vitit shkollor dhe të përfundojë jo më vonë se dy muaj pas ditës së fillimit të vitit të ri shkollor.

7. Transferimi i nxënësit nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë të AP, bëhet me kërkesë nga nxënësi, ose prindi/kujdestari i tij dhe shoqërohet me certifikatën/dëftesën e nivelit paraardhës dhe dokumentacionin tjetër që vërteton plotësimin e kritereve të veçanta (nëse ka).

Neni 3

Transferimi horizontal brenda sistemit të AFP-së

1. Në Arsimin Profesional, nxënësi që përfundon me sukses një kualifikim profesional në një nivel të caktuar, në një drejtim/profil të caktuar, mund të vijojë kualifikimin profesional të nivelit pasues vetëm në drejtimin/profilin e kualifikimit që ka përfunduar.

2. Nëse struktura e kualifikimeve profesionale mundëson profilizimin në kualifikimet profesionale pasadhëse, nxënësi ka të drejtë të vijojë kualifikimin vetëm në njërin nga profilet profesionale që janë pjesë e drejtimit profesional përkatës.

3. Në një nivel të caktuar të kualifikimit profesional, ndërrimi i drejtimit mësimor ose i profilit mësimor (brenda drejtimit mësimor përkatës) mund të bëhet vetëm gjatë vitit të parë të kualifikimit, por jo më vonë se dy muaj nga dita e fillimit të vitit shkollor.

4. Përzgjedhja e profilit mësimor ose ndërrimi i drejtimit/profilit mësimor bëhet me kërkesë nga nxënësi, ose prindi/kujdestari i tij dhe shoqërohet me dokumentacionin tjetër që vërteton plotësimin e kritereve të veçanta (nëse ka).

Neni 4

Institucionet zbatuese

Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi njësiat përkatëse e AFP pranë ministrisë përgjegjëse për AFP dhe ofruesit publikë dhe jopublikë të AFP-së.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Arben Ahmetaj

